

LIGJ
Nr.7644, datë 2.12.1992

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.6133, DATË 12.2.1980 "PËR TITUJT E NDERIT DHE
DEKORATAT E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.6133, datë 12.2.1980, "Për titujt e nderit dhe dekaratat e Republikës së Shqipërisë", neni 25 ndryshohet si vijon:

"URDHRI DHE MEDALJA "PËR MERITA TË SHQUARA NË FUSHËN E MBROJTJES SË ATDHEUT".

Urdhri dhe medalja "Për merita të shquara në fushën e mbrojtjes së atdheut" u jepet oficerëve e nënoficerëve aktivë e rezervistë, studentëve të akademisë ushtarake, ushtarëve aktivë e rezervistë, njësive, reparteve, nënreparteve e institucioneve ushtarake me këto motivacione:

Për merita të veçanta dhe aftësi të shquara në forcimin dhe modernizimin e ushtrisë; për trimëri të treguar në rast agresioni ose provokacioni kundër Republikës së Shqipërisë; për rezultate të shkëlqyera në përgatitjen ushtarake të efektivave, si dhe në fusha të tjera që kanë çuar në forcimin e gatishmërisë luftarake.

Urdhri "Për merita të shquara në fushën e mbrojtjes së atdheut" ka tri klasa: I, II, III".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.389, datë 9.12.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.